

HAPEN PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së Nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga Ministri i Drejtësisë për të ofruar ndihmën juridike parësore duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit

Kujdes: Dokumentacioni duhet të jetë në format *origjinal ose i njehsuar me origjinalin*, si dhe *i përditësuar*!

Dokumentacioni që duhet të depozitojnë organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim, për marrjen e autorizimit që lëshohet nga Ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
- b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridik ;
- c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:

- i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
- ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare të nënshkruara nga ekspert kontabël i miratuar;
- iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
- iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;

- ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
- e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.
- f) adresën elektronike të komunikimit.
- g) Numri unik i identifikimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*referuar përcaktimeve të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Mungesa e numrit unik nuk është shkak për skualifikim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër që nga implementimi i ligjit dhe vonesat në zbatimin e tij*)

Aplikimi për autorizim i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në adresën Rr.“*Jordan Misja*”, Godina nr.3, Njësia Bashkiake nr.9, Tiranë, brenda datës **17.07.2022**.

Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen.